



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.731/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit GCF Generale Construzioni Ferroviarie SPA Dega në Kosovës, me seli në Qagllavicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Dastid Pallaska avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, K.F.nr.112/24 të datës 26.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit GCF Generale Construzioni Ferroviarie SPA Dega në Kosovës, me seli në Qagllavicë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, K.F.nr.112/2024 i datës 26.02.2024, Vërtetohet

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, është Refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit GCF Generale Construzioni Ferroviarie SPA Dega në Kosovës, me seli në Qagllavicë, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.protok.01.3.2.2/24164 datës 22.01.2024 të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të

plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes thelbësore të dispozitave të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa si faktikisht dhe juridikisht e themeltë ankesa e paditësit kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, K.F.nr.112/2024 i datës 26.02.2024, të Anulohet si i pathemeltë aktvendimi i atakuar, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Dhoma e shkallës së dytë, duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së paditësit, gjen se dhoma e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.protok.01.3.2.2/24164 datës 22.01.2024 i të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka refuzuar kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit-aktit administrativ të paditurës, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të kontestuar. Gjykata nuk ka gjetur asnjë provë të vetme me të cilën do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ. Propozuesi-paditësi nuk ka dëshmuar se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i riparueshëm, se ekziston rreziku i shkakut të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues. Propozuesi nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë konkrete se ekzekutimi i vendimit kontestues do të mund ti shkaktonte dëm të riparueshëm ashtu siç është përcaktuar me nenin 22 par.6 e lidhur me par.2 të LKA-së.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të dhomës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohet, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se dhoma e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit

të vendimit nr.protok.01.3.2.2/24164 datës 22.01.2024 i të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ kontestues. Meqë në këtë rast paditësi, në ankesën e ushtruar nuk ka bërë të besueshme pretendimet e tij, se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së, Kolegji vlerësoi, se pretendimet ankimore nuk ndikojnë në ndryshimin e një gjendje tjetër faktike që e ka konstatuar dhoma e shkallës së parë.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nuk i vlerësoi si të bazuara pretendimet ankimore se rreziku i falimentimit të paditësit vjen si pasojë e zbatimit të aktvendimeve të kundërligjshme e vërtetuar me analizën e kontabilistit të jashtëm të paditësit, si: provat e gjendjes së llogaris bankare të paditësit, detyrimet tatimore të vendosura në mënyrë të kundërligjshme. Duke marrë parasysh se e paditura ka nxjerr aktvendimin administrativ kontestues, lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar ndaj aktit administrativ të paditurës Dogana e Kosovës, Sektori i Kontrollit Pas-Importues, që ka të bëjë me detyrimin për pagimin e obligimit doganor në emër të taksës së akcizës dhe tvsh-së, Kolegji vlerësoi se pretendimet ankimore tani në këtë fazë, nuk janë të mjaftueshme dhe bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu aprovuar propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Pretendimet ankimore kryesisht janë të drejtuara çështjes kryesore ku paditësi është ngarkuar me obligime tatimore/doganore, e që tani këto pretendime nuk mund të shqyrtohen me rastin e propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, ndërsa në vështrim të nenit 22 të LKA-së, Kolegji nuk i vlerësoi si pretendime të argumentuara deklaratimet e paditësit, në pamundësinë e pagesës së detyrimeve shtesë nga e paditura, apo falimentimi i paditësit në rast të zbatimit të akteve administrative të kundërshtuara.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata e Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të propozimit të paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës. Sipas vlerësimit të Kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i dhomës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhomat e shkallës së dytë.

Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.731/24 datë 02.04.2024

Kryetari i Kolegjit

Krenar Berisha